

KOSOVARJA

Ballina: Majlinda Topanica

**Pse
në Kosovë
të gjithë janë
të mençur**

**Një ditë
pazari
në Podujevë**

**Pse i linda
26 fëmijë
për inati**

***Majlinda Topanica
ylli i këngës që gëzimin
e mërzinë i kalon me muzikë***

**Salih Sefa
njeri me
9 shpirtra**

**Ç'hotë
fotografi
i njohur
Fadil
Berisha**

**Takime
të shumta
të UB-së**

remos

DENTFIX

SPORT

**HELPER
GENÈVE**

SHERWOOD

MARITIM

allure

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

**DINO
CERAMICHE**

Shkabaj

MOLLA

Shkenda Dybesh

Banaderm

BREZOVICA

CIMA



DINO KERAMIKA

Kush Jemi Ne HISTORIA DHE FILOZOFIA

Kompania DINO filloi si një biznes individual në vitin 2000. Gjatë viteve, grupi ka ndërmarrë shumë projekte sfiduese dhe aftësi të akumuluar, njohuri dhe përvojë në krijimin e zgjidhjeve, shërbimet e menaxhimit të projektit, tregtinë e ndërtesave dhe punimet inxhinierike të ngjashme, shitjen e qeramikës, bluarja dhe shitja e gurit, si dhe furnizimet me energji. Kompania ofron një cilësi të lartë për klientët, pavarësisht nga sektori, duke provuar veten lider të industrisë gjatë viteve. Kompania prodhon të gjitha klasat e betonit sipas standardeve të ndërtimit, si dhe transportin në destinacionin përfundimtar, prodhimin e të gjitha fraksioneve të zhavorit, shitjen dhe transportimin në destinacionin përfundimtar, furnizimin e të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, furnizimin e qeramikës. Shitje me shumicë dhe pakicë nga fabrikat më të njohura italiane dhe shitja e drejtpërdrejtë e lokaleve të biznesit dhe apartamenteve. Kompania është Partner i autorizuar për furnizim me keramike



Magjistralla Prishtinë-Ferizaj, Konjuh - 14000 Lipjan



+383 49 566 667



Dino Qeramika



www.dino-company.com



DINO COMPANY

MAGJISTRALJA PRISHTINE-FERIZAJ km-2, 14000 LIPJAN, KOSOVË

+383 44 206 586

www.dino-company.com

Dino keramika, është kompani e cila ofron produkte me shumice dhe pakicë, një game të gjerë të llojeve të keramikës të cilat vijnë nga fabrikat me të njohura italiane dhe spanjolle ; "mirage", "azuvi", "ecoceramic"

Strukturë dhe ngjyrë të veçantë, efekte që kënaq shijet dhe nevojat estetike, kombinime të koordinuara, kontraste dhe përshtatje.



BREZOVICA HOTEL & SPA

info@brezovicahotel.com

www.brezovicahotel.com

049 30 10 30, 045 60 70 70





Majlinda Topanica,
ylli i këngës që gëzimin e mërzinë
i kalon me muzikë



Majlinda Topanica është zë i mrekullueshëm që jehon prej vitesh në skenën tonë muzikore, në mbrëmje rinore, dasma e ahengje. Është këngëtarja që këndon “live”, madje dëgjohet larg e bukur edhe pa mikrofon. Talentin e zërin ia ka falë Zoti, e dashuria për këngën i është rritur vit pas viti, bashkë me emrin e saj si këngëtare e vërtetë...

Majlindë, ju këndonit që në fëmijëri. Kur ktheheni në të kaluarën, çfarë ju vjen në mend?

- Kam shumë kujtime, por një prej më të bukurve është kur të gjithë fëmijët e lagjes mbledheshin dhe vinin për të më përcjellë teksa këndoja në koncerte dhe bërtisnin me zë të lartë: “Majlinda! Majlinda!”. Ndihesha aq e lumtur sa që më dukej se fluturoja nga gëzimi...

A të kujtohet kënga e parë që e ke kënduar dhe ndjesia që të ka dhuruar?

- Më kujtohet që shkoja në ditët e festave të shkollave dhe këndoja me çifteli. Pra, i këndoja disa këngë me radhë. E di që zëri më dridhej nga emocionet, sepse kisha përballë një publik të mrekullueshëm, që vinin për t’me parë e dëgjuar.

Kush ishte njeriu i parë që të dha zemër për të dalë në skenë dhe të mbështeti pa kursim?

- Ishte babai im i ndjerë, i cili para shumë kohësh ka qenë këngëtar, ka kënduar nëpër koncerte, por që mjaft i ri e ka ndërprerë muzikën, meqë nëna ime kishte qenë shumë xheloze.

Më ka ndihmuar në çdo mënyrë që unë t’ia dalë dhe të jem e suksesshme.

Sot shumëkush bën këngë. Dikur ka qenë më ndryshe, apo?

- Dikur gjithçka ka qenë më ndryshe, nisur nga fakti se vetëm talenti të ka hapur rrugë. Sot, kush po do po bëhet këngëtar e këngëtare.

Cila është kënga që të dha famë ose, më saktë, të bëri Majlindën që njohim sot?

- Ishte kënga “Je ka lun qysh po don vetë”. E, kjo këngë në atë kohë dëgjohej kudo në radiot e televizionet tona.

Po, kënga që e këndon më me zemër?

- Është një listë e gjatë e këngëve që i këndoj me zemër, e posaçërisht ato të këngëtarit të madh Ramadan Krasniqi. Këngët e tij i këndoj me shpirt, sepse m’i do zemra...

Cilat këngë e ndezin publikun, atmosferën?

- Nëse flasë për në Zvicër, ku edhe jetoj, në mbrëmje rinore nëse nuk di të këndosh tallave, harroje atmosferën...

Pra, pa tallave të gjithë ulen dhe askush nuk vallëzon. Tallava ja ua lëvizë vetë këmbët! Është e çuditshme, a?!





Jeni këngëtare e mbrëmjeve muzikore, dasmave e ahengjeve. A pritet të kesh sezon të nxehtë?

- Në korrik e gusht jam tejet e angazhuar në dasma e ahengje. Besoj që do të jetë sezon i mirë dhe produktiv dhe se çdo gjë do të shkojë "ok"...

Muzika "live" është specialiteti yt. Çka mendon për këngëtarët që nuk këndojnë "live"?

- Këndoj gjithmonë "live". Ata që nuk e bëjnë këtë gjë nuk i kam në qejf. Sidoqoftë, sot kushdo bëhet këngëtar, edhe pse nuk i kanë dy lidhje me muzikë! E, besa, bash këta po i thonë vetit me krenari këngëtar, po bëhen shumë të famshëm!

Ke në plan ndonjë këngë a album muzikor?

- E kam në plan një këngë të re, të shoqëruar me videoklip, por që nuk dua të specifikoj kohë apo datë se kur do të jetë gati për publikim.

Meqë duetet janë në trend, a ke planifikuar ndonjë duet me dikë nga kolegët?

- I kam pasur disa duete muzikore. Tash e kam një planifikim për një duet me një këngëtar, por nuk është asgjë në fazën që do më lejonte të flisja haptazi, konkretisht. Të shohim pas sezonit...

Jeta private e Majlinda Topanicës është...?

- Nuk kam dëshirë të ndalem shumë te kjo pjesë, meqë nuk dua ta përziej jetën private me punë e biznes. Më tepër më pëlqen të flasë për punën dhe projektet e mia muzikore...

Hobi, pasioni... Apo as për këto nuk dëshiron të flasësh?

- Për këto mund të flasë... Fitnes kam dëshirë të bëjë çdo ditë, shoppingun e kam në qejf, ndërkaq muzikën në shpirt.

Kur nuk ndihesh mirë, si ia ndreq vetes disponimin?

- Kur jam keq këndoj balada. E, ato ma qetësojnë shpirtin. Pra, edhe mërzinë e kaloj me muzikë...

Me kë dhe ku do t'i kalosh pushimet e kësaj vere?

- Normalisht, me familje. Pushimet, zakonisht, i kryej para sezonit dhe më pëlqen t'i kaloj në Turqi. E, pas sezonit kam dëshirë t'i kalojë disa ditë në bregdetin shqiptar...

Suksese dhe faleminderit për bisedë!
- Faleminderit edhe juve!

Nderim Neziri

PSE E SHAJMË VETVETEN?



...dielli është i madh dhe ndriçues, por prapë e lë gjysmën e botës në terr. Kjo do thotë, sado e madhe të jetë mirësia në këtë botë, largësia do të ekzistojë. Çfarë më habit? Njeriu! Është i shqetësuar për të tashmen. Pse?

Ai nuk jeton dot as sot, as nesër. Ai jeton sikur nuk do të vdesë kurrë dhe vdes pa jetuar kurrë si duhet... E, llogaria telefonike është dëshmia më e mirë që tregon - më mirë është të heshtësh sesa të flasësh. Vjen një ditë dhe gjithçkaje i vjen fundi. Prandaj, mos e merr jetën aq seriozisht. Askush nuk ka dalë i gjallë prej saj, prej jetës. E ne, që e shajmë jetën, nuk e kuptojmë se e shajmë veten tonë, sepse jemi ata që e bëjmë jetën të tillë.

*

Pse u dashka të vdesë njeriu?
I kthehem të sotmes.
Sa zhgënjyese është!
Çfarë njerëzish jemi ne?
Ku na çon e gjithë kjo?

U harruan njerëzit që kanë bërë shumë për –këtë vend e këtë popull!

U harruan ata, që dikur ishin dikush, në çdo pore të jetës, në përballje me përjetimet e zorshme të ditëve të përgjakura...

Eh, sa emra kanë mbetur nën pluhurin e harresës, të cilëve u ka shkuar jeta në shërbim të kauzës shqiptare?!

“Nuk jam i kënaqur me situatë tonën të turbullt! Nuk kam vullnet për asgjë, bash për asgjë!”, më thotë im mik, e që rrallëherë e çelë gojën për ndonjë muhabet më të gjatë.

Sot, disi, pajtohem edhe unë me të... Kot mundohesh, krejt konfuzion është bërë. Atëherë ishim e jetonim keq, ama ecnim drejtimit tonë. E tash, të lirë, por krejt në mjegull...

I jetoj ditët e pleqërisë. E rëndë dita, e aq më e rëndë nata, si për inati.

Në muret e dhomës ku qëndroj dhe e kaloj një pjesë të kohës duke “shkarravitur” ndonjë shkrim herë pas herë, shpesh më shkojnë sytë në disa portrete, të cilët kur i shikoj sikur më qortojnë e më fajësojnë për gjendjen e tashme, të sotme...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

Shëtitje në grupe, hallakamë në çajtores!

Në Podujevë 60 për qind e popullatës është moshë e re, ashtu si ndodh edhe në komunat e tjera të Kosovës. Papunësi e madhe, si kudo tjetër në Kosovë. Në mungesë të vendeve të punës, ëndrrat e të rinjve thyhen, ambiciet zbehen. Plagosja e këtyre ëndrrave shkakton uragë, që shprehen me depresion. Perspektivën të rinjtë e kësaj komune, por edhe të komunave të tjera të Kosovës, e gjejnë në filxhanin e kafes, në makiatot që i gjen në çdo lokal të kësaj komune, e që janë me bollëk...

Të rinjve llapjanë, edhe pse kaluan 23 vjet nga lufta, u mungon shumëçka që kanë moshatarët e tyre, bie fjala, në Prishtinë. Shumicën e kohës të rinjtë llapjanë e kalojnë në kafiteri apo në rrugë duke shëtitur. Megjithatë, nuk u mungon shpresa për ditë më të mira, edhe pse drita nuk shihet as në fund të tunelit... Besimi, Drita, Nita, Çlirimtari, si dhe shumë të rinj të tjerë të kësaj komune, mendojnë se në Podujevë mungojnë kushtet elementare për jetë, e të mos flasim për argëtim... Megjithatë, rruga kryesore e Podujevës çdo ditë gumëzhijnë nga të rinj, aq sa nuk di njeriu a është kohë mësimi a pushimi, ngase kudo hasësh në nxënës e të rinj të tjerë që tërë ditën bredhin poshtë-lart, pa pasur idenë se si ta shpenzojnë kohën, energjinë dhe si të bëjnë me jetën që nuk u ofron shumë... "Paj, s'po kemi ku të rrimë! Në kafiteri po pimë makiato, po bisedojmë... Po shëtisim si "ushtarët në grupe" rrugëve...", thotë Besimi, i cili vitin e kaluar e ka kryer shkollën e mesme dhe nuk ka pasur mundësi të regjistrohet në fakultet, sepse nuk e ka dhënë provimin pranues. Edhe pse në moshë të mirë për punë, ai nuk sheh perspektivë në Podujevë, veç me ia ther diku jashtë. Sepse, siç thotë ai, veç kafiteri dhe femra kemi me bollëk, e të tjerat na mungojnë... Besimi ankohet se pak nga moshatarët e tij, që e kanë kryer vitin e kaluar shkollën e mesme, punojnë në institucione të komunës. Kush ka pasur të njohur punon në ndonjë lokal, ndo-

kush në studime, e të tjerët shëtisin rrugëve të Podujevës me ndonjë cent në xhep, e ka të tillë edhe pa asnjë cent. Por, Besimi nuk i ka humbur shpresat se sivjet do del edhe ndonjë vend pune për të, siç thotë: "S'paku mund të largohem për tetë orë nga rruga dhe thashethemet e shëtitjet pa lidhje...". Besimi, ndërkaq, mendon se Podujeva mbetet ndër komunat më të pazhvilluara me faktin se mungon ekonomia e këtij qyteti, që do të hapte vende të reja pune.

JETA ARGËTUESE HËËË...

Sipas tij, por edhe sipas Dritës e Nitës, nxënës të shkollës së mesme, Podujeva edhe më tutje mbetet pa jetën e organizuar kulturore dhe argëtuese për të rinjtë, për moshatarët e tyre. E, deri kur, mbetet të shihet... Sepse, dritë nuk shihet as në fund të tunelit!

D. Haxhaj



Njeriu me 9 shpirtra!

Sali Sefa është lindur në fshatin Prapashticë, fshat i cili sa e sa herë ka pasur furtuna, është goditur nga masakrat serbe. Saliu rrjedh nga një familje që shkollonte dhjetë fëmijë, përballë sfidave të kohës, që ishin të natyrës politike...



Shkollën fillore e bëri në vendlindje, të mesmen dhe fakultetin e mjekësisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Berlin të Gjermanisë.

Ish-i burgosur politik nga viti 1984, vuajti dënimin në Prishtinë, Leksovc e Nish. Pas largimit nga Kosova ka bërë 17 vjet punë në një klinikë sportive në Berlin, 9 vjet punë si diplomat në Zvicër, rreth pesë vjet shef i misionit konsull në Cyrih të Zvicrës dhe 3 vjet shef i seksionit konsullor pranë ambasadës së Kosovës në Bern. Salih Sefa ka trashëguar pasoja të rënda shëndetësore nga koha e vuajtjes së dënimit, që shumicën e ka kaluar në izolim dhe në burgjet e vetmisë.

Në dhomat e tij të vetmisë, zyrtarët serbë të burgjeve dërguan serbë të rrezikshëm për ta nënshtuar dhe paaftësuar shpirtërisht dhe fizikisht. Njohësit e rrethanave të vuajtjes së dënimit të tij, për shkak të mizorive serbe mbi të, Salih Sefën me të drejtë e quajnë "njeri me nëntë shpirtra"!

VEPRIMTARIA POLITIKE E SALIH SEFËS

Rreth punës së veprimtarisë së tij politike, Salih Sefa, thotë:

"Në klasën VI fillore kam pasur fatin ta kem mësues Hilmi Rakovicën, i cili, posa ishte liruar nga burgu, erdhi mësues në shkollën tonë.

Në fakt, e sollën në shkollë Isa Zeneli dhe Sheqir Zeneli (më vonë ish-i burgosur politik), mësimdhënës në Shkollën Fillore "Afërdita" në Dabishec.

Fatkeqësisht, Hilmiu vetëm 6 muaj ishte mësues dhe na e mësoi simbolikën e alfabetit të burgjeve, që bëhej me trokitje në mur.

Dhe, për të parën herë në jetë, atë e kam dëgjuar duke na rrëfyer për burgun dhe për të drejtat e shqiptarëve atëherë...

Në vitin 1980, të udhëhequr nga Sejdi Veseli, kemi themeluar organizatën ilegale "Fronti Nacional Çlirimtar". Më vonë ia kemi ndërruar emrin në "Fronti për Çlirim Kombëtar".

Është shumë me rëndësi se demonstratat e vitit 1981 na gjetën të organizuar. Veprimi i atëhershëm ishte në ilegalitet të plotë.

Demonstratat e vitit 1981 nuk ishin spontane, sikur i cilësonin disa, por ishte një akt reagimi që ishte përgatitur për shumë vite më herët nga veprimtarë të shumtë.

Nata e 11 marsit 1981 ishte vetëm një shkëndijë në mensën e studentëve, që nisi me thyerjen e një pjate, për të vazhduar me demonstrata të tjera që u përhapën në gjithë rrjetin e organizmit studentor.

Dhe, nga nata e 11 marsit e deri më 26 mars, kishim tri javë të mjaftueshme që demonstratat të bëhen me organizim të plotë, me kërkesa të qarta, të definuara.

Më nuk ishin vetëm kërkesa sociale, por edhe politike për Kosovën-Republikë.

Parulla të shumta u shkruan në konviktet e studentëve nga Bajram Kosumi, Riza Demaj, Musli Kosumi dhe shumë studentë të tjerë, që nuk mund t'i përmendi të gjithë.

Por, nuk ishin vetëm ata, sepse edhe në fakultetet tjera kishin filluar shushurimat dhe kontaktet mes vete, gjë që kisha filluar edhe personalisht të jem në qendër.

Më kujtohen shumë ngjarje e takime me shokë. Duhej punë e palodhshme, por në përshtypje më ka mbetur puna me Dr. Fatmir Xhelilin, atëherë student, e më vonë ish-pjesëtar i UÇK-së dhe ish-deputet shumëvjeçarë.

26 marsi ishte data kur stafeta e Titos duhej të vinte në Kosovë, konkretisht në Prishtinë, e qëllimi i asaj dite ishte që ne, studentët, t'ia thyejmë kahun e t'u tregojmë antishqiptarëve dhe komunistëve të stafetës se ne jemi shqiptarë dhe nuk kemi lidhte asgjë me stafetën e Titos, që ishte bërë modë tradicionale ta masovizonte rininë çdo pranverë.

Më 26 mars patëm konfrontime të mëdha me policinë. Filluan edhe burgosjet e para. Nisi përdorimi i dhunës policore mbi studentët dhe pati edhe vrasje e plagosje.

Ngjarjet e vitit 1981 tashmë dihen për opinionin, por dua të merrem pak nga viti 1981-1984, kur u burgosa unë.

Ishin ato javë, muaj e vite shumë të vështira. Ndodhte një revolucion i vërtetë, sepse s'kishim frikë se na burgosnin, por ishte shumë e rëndë kur na mungonte ndonjë koleg, e të tilla raste kishte çdo ditë.

Thash, ndodhte një revolucion popullor në Kosovë, sepse qanim kur dikë e kapnin policia e ne ishim ende të lirë... Ndjenim

Bisedë me ish-të burgosurin politik, Salih Sefa

keqardhje që ne ishim akoma në liri...

U krijuan vitet e arta të simpatisë për ata që burgoseshin për qëllime lirie, lidhur me demonstratat e vitit 1981.

Unë dhe shokët e mi, bashkë me Sejdiun, mundoheshim që familjet e të burgosurve t'i ndihmonim moralisht dhe materialisht. Në janarin e vitit 1982, "Fronti për Çlirim Kombëtar" kishte marrë përsipër ta mbante përvjetorin e demonstratave dhe unë isha caktuar nga grupi të udhëtoja në Stamboll. E të takohesha me bashkëpunëtorët e ilegales atje për direktiva të mëtejme.

Më kujtohet, një ditë para se të udhëtoja, ka ardhur një qëndrim tjetër të mos shkojmë fare, por të vazhdojmë me aksione të tjera të herëpashershme, mundësisht të koordinuara, sepse kishin dal shumë grupe dhe kështu kemi vazhduar deri në janar të 1984", elaboron detajet e asaj kohe Salihu.

VEPRIMTARIA DERI NË ARRESTIM

"Një detaj duhet ta themi për Sejdi Veselin, diku më 1983, në një takim tonin ilegal", vazhdon rrëfimin Salihu dhe shton:

"Sejdiu ishte shumë i gëzuar dhe na tha se tash kemi bërë lidhje edhe me grupet e tjera dhe me veprimtarë shumë të fuqishëm të çështjes kombëtare dhe jemi çdo ditë më të përgatitur. E, më vonë kam kuptuar se fjala ishte për dy heronjtë tanë kombëtarë: Rexhep Malën dhe Nuh Berishën.

Natën e datës 10-11 janar 1984 u zbuluan Nuh Berisha, Rexhep Mala dhe Kadri Osmani, në shtëpinë e Sejdi Osmanit. Po atë natë u vranë Rexhep Mala dhe Nuh Berisha, ndërkaq Kadri Osmani mbeti i plagosur në Vranjevc, pasi nuk mundi ta kërcente murin e një oborri.

Nuhiu dhe Rexhepi luftuan deri kah mëngjesi, Kadriu u kap e Sejdi Osmani u burgos me 5 vëllezërit e tij.

Prej asaj nate, arrestimi dhe dënimi ynë ishte çështje orësh dhe vetëm prisnim kur do na i vënin prangat.

Unë në atë kohë punoja teknik medicinal në shtëpinë e shëndetit në Prishtinë dhe isha në terren.

Dhe, përveç shokëve, treshes sonë, Sejdi Veseli dhe Hamdi Rafuna, që ishin me mua, kishte dije edhe një person që punonte në shtëpinë e shëndetit të Xhamia e Llapit, Xhevahire Shala.

Më 23 shkurt të vitit 1984, posa mbërrita në shtëpi, nuk ka zgjatur as 2 minuta kur vëllai më trokiti në derë dhe tha po të thërrasin do shokë.

Me të dalë në derë më kanë kapur në shpejtësi e s'më kanë lënë as të

mbathem...

Të njëjtën ditë ishte burgosur edhe Hamdi Rafuna, ndërsa shoku tjetër i klasës, Musli Prebreza, ishte burgosur një javë më herët. Në vitin 1984, muajt janar, shkurt, mars, prill, kanë qenë ndër muajt më të tmerrshëm të arrestimit dhe dënimit të më së shumti grupeve ilegale.

Dënimi është bërë në muajin qershor. Grupi ynë u dënua prej 3-14 vjet heqje lirie. Numerikisht, u dënuam 20 anëtarë të grupit tonë dhe 6 të mitur me nga 4-8 vjet. Dhe, për të burgosurin politik, dita e gjykimit është festa më e madhe, sepse një i burgosur ka mundësi të rrëfëhet dhe ta thotë fjalën përfundimtare. Fatkeqësisht, gjyqtari i atëhershëm, Ahmet Ahmeti, si dhe prokurorët e porotët nuk na lejuan t'i shprehim faktet tona.

Diçka që nuk më hiqet nga mendja është se "Rilindja" kishte shkruar se gjatë gjykimit Hamdi Vitia është penduar dhe të nesërmen Afrimi kërkoi që ta merr fjalën në gjykatë për ta kundërshtuar versionin e atij botimi, atë që ishte shënuar për Afrimin.

Por, Ahmet Ahmeti nuk e lejoi. Ndërkaq, Afrimi, me një zë të thekshëm, tha se unë kurrë nuk pendohem dhe kurrë juve s'ju njoh!

Pra, kështu tregohej vendosmëria e çdo të burgosuri, sepse neve na pyesnin a pendohesh a jo. E, prej të gjithë të burgosurve askush nuk është penduar...

Sidoqoftë, nuk dua të lëshohem në detaje, por e them për lexuesit e rinj që të mos e harrojnë mundin e veprimtarëve të vjetër, se hetimet në atë kohë kanë qenë të tmerrshme...

Po ashtu, nuk them se të gjithë pjesëtarët e sigurisë bënë tortura, por të gjithë ishin shqiptarë".

KËNGËN SE NDALNIN EDHE KUR I DËNUAN!

"Dhe, atë ditë që jemi dënuar, ishim në përcjellje të mëdha prej gjykatës së Qarkut e deri te burgu, por në asnjë moment nuk është ndal kënga e të burgosurve në "maricat" policore. Kemi kënduar dhe s'jemi mërzitur, por kemi shprehë gëzim për dënimin tonë.

Kur na kanë dërguar në burg, gardianët bërtitnin kur kemi hyrë në çeli duke kënduar...

Në dhomë erdhi Halil Alidemaj. Dhe, kur më pyeti sa jam dënuar, më tha se e ka pasur të qartë dënimin se sa do të dënohem...

Edhe sot, edhe dje, por edhe nesër, derisa të frymojë, do ta përkujtojë dhe do të mundohem t'i zbatojë mësimet që i kam marrë nga ai person i jashtëzakonshëm,

dijetar dhe trim i pashoq.

Gjendja e Halilit ishte e rëndë dhe e kishin sjell në rigjykim pas tre vjet burgosjeje në burgun e Beogradit, e grupi përbëhej nga Halil Alidemaj, Ukshin Hoti dhe Ekrem Kryeziu.

Gjatë netëve kur ishte kohë gjumi, venim një batanije mbi kokë dhe bisedonim tërë natën për punë kombëtare...

Halili ka qenë shumë i torturuar gjatë kohës së hetuesisë, ndërsa nga e kaluara e burgut në Beograd dhe nga hetimet e para, edhe pas tre vjet, ende i kullonte një plagë në shpinë, që i ishte hapur si pasojë e torturave mizore ndaj tij", tregon Salihu.

TRANSFERIMET NË BURGJET E VETMISË

Nga burgu i Prishtinës, Salihun me disa të burgosur të tjerë, i transferuan në Burgun Hetues të Leskovcit. Ai vetë tregon më së miri për këtë proces dhe tek evokon këtë histori, thotë:

"Ishte natë shtatori kur u hapën dyert dhe na thanë t'i merrnim të gjitha që i kishim aty. Isha i veshur me rroba sportive dhe shokët më dhanë rroba, dardha e rrush, që të kisha pak ushqim me vete, sepse kur të na çonin në burgje të tjerë, si të burgosur të rinj, mund të mos kishim ushqim për një kohë.

Kur më qitën te dera e burgut, sa ishim ende në Prishtinë, kishte qenë edhe një i burgosur tjetër. Mua më lidhën me Kadri Osmanin. Na kanë hipur në ato "maricat" e famshme, të lidhur për duar dhe na kanë dërguar në burgun e Gjilanit.

Pastaj, Kadriu e kanë hipur në një "maricë" tjetër, e mua, Sali Malën, Bedri Bajramin dhe një person tjetër, e që më duket se ka qenë Sadri Ramabaja, i cili gjatë rrugës nga Gjilani deri në Vranjë na trimëroi që të mos na zë në befasi asgjë, tha se tash do t'i shihni sadistët çka bëjnë... Si duket, ai torturat i kishte përjetuar edhe më herët...

Sadriu e kanë lënë në Vranjë, ndërsa mua më kanë dërguar në burgun e Leskovcit. Në burgun e Leskovcit na pritën tmerrshëm, duke na vendosur mes kordonësh me policë dhe duke përdorur dhunë, pa ditur kah vinte... Duhej të ulnim kokën dhe të kalonim mes tyre, duke përjetuar grushte e drunj dhe mjete tjera të forta mbi ne.

Sidoqoftë, për ato tortura kam folur në një emision dhe nuk po hy në detaje, por një muaj nuk kemi ditur ku jemi...

Pas torturave na ndanë nëpër qeli. Në dhomën që më dërguan mua ishte edhe Bedri Bajrami dhe Kadri Llugaliu. Dhe, kur na veshëm me rrobat e burgut, në dhomë nuk e njihnim njëri-tjetrin...

Pas një kohe kanë filluar me pyetje dhe me injorim se për çka jemi dënuar. U tregova se jam dënuar me nenin 131. E, ata kërcyen si zorra në prush, duke më thënë: "Matematikë po na tregon neve, a?!". Dhe, nisën t'më rrihnin pandërprerë. Në një moment, më thanë: "Zhvishu, hiqi rrobat!".

Jam zhveshur, kam mbetur vetëm në brekë.

Filluan torturat se pse nuk isha zhveshur tërësisht, deri në alivanosje...

Pastaj, na i dhanë rrobat e burgut që ishin pa lidhëse, të shqyera, të gjera, të përgjakura... Në ato momente m'u kujtuan fjalët "do t'i shihni sadistët"...

Aty më kanë mbajtur 33 muaj. Unë kam menduar se kur një person dënohet, dërgohet për dënim e nuk e kam ditur se ai dërgohet për tortura dhe hetim, edhe kur ato të kenë marrë fund proceduralisht. Sidoqoftë, mund të them se në burgun e Lekovcit kanë vazhduar torturat dhe sjelljet më mizore mbi të burgosurit shqiptarë...

Një ditë, në një moment kur na nxorën në shëtitore, dolëm, siç ishte zakoni. Duhej të ecnim njëri pas tjetrit, me kokë ulur dhe me duar të lidhura pas shpine. Dëgjuam një zë kur tha – eja! E, kur jemi ofruar për të hyrë në qelinë tonë, gardianit ma zgjati gazetën "Rilindja", të cilën ma parapaguanin nga Prishtina dhe ma sillnin më vonë, pasi i shqyenin të gjitha fletët e politikës.

U futëm në qeli dhe, sipas rendit shtëpiak, ne duhej të shkonim me kokë ulur dhe të prisnin deri ta mbyllnin derën e qelisë. Kaluan disa sekonda dhe nuk e mbyllën derën. Dëgjuam hapat. U fut në dhomë një gardian i madh. Filluam të rrudhim trupin, duke pritur kur po na bie...

Por, për befasinë tonë, ai tha: "Kthehuni!". Na pyeti për dënimin dhe shau serbisht se shumë na kanë dënuar...

Sidoqoftë, menduam se po na provokon, por, pastaj, na pyeti si janë sjellë dhe si po sillen këtu gardianët. Ishte një pyetje e zorshme për përgjigje, sepse po t'i thuash se na kanë torturuar, mendonim se ai thoshte mirë ua kanë bërë. Por, edhe nëse nuk tregonim se çka na kishin bërë, nuk donim të gënjenim dhe i kam thënë: "Ju e dini si sillen këtu!".

Dhe, në atë çast ka dalë jashtë. Por, unë e kisha problemin e vizitës për të nesërmen, e ata punonin nga 24 orë në ditë... Vizita ishte gjatë ndërrimit të tij, e lutesha të mos qëllonte ai në ndërrim, sepse torturat na bëheshin pikërisht në ditët e vizitave, e qëllimi ishte që ne të dilnim sa më të rraskapitur para familjeve tona...

Të nesërmen u hapë dera dhe mua më kërkoi i njëjti gardian. Tha: "Eja me i marrë rrobat e familjes!".

Për befasinë time, ai nuk i kontrolloi shumë rrobat e dërguara, por ajo që më bëri përshtypje ishte se familja kishte gatuar mantia dhe ai më pyeti çka janë... Dhe, kur i thash se janë mantia, tha a bën me provua një... E mori dhe e hëngri... Pasi doli, nuk vonoi shumë dhe erdhi po i njëjti. Më tha: "Eja në vizitë!".

Kur dola te familja, vizita, që zakonisht ishte pesë minuta, më la me familje 20 minuta!

E, kur u krye vizita, më kthyen në qeli. Aty iu drejtova shokëve, Bedriut dhe Kadriut. U thash nga sot duhet të ruheni nga unë... Sepse, i mora teshat e nuk m'i kontrollovan! Fola në vizitë e nuk më penguan! Ose unë jam bërë i tyre, ose diçka ka ndryshuar?!

Por, nuk vonoi shumë e mësuam se ai gardian ishte nga Topalla e Medvegjës, konkretisht nip i Zenel Hajdinit.

Po ai, më vonë, për 6 muaj sa ka shërbyer në burg, na sillte libra prej një dhome në tjetrën...

Dhe, me muaj s'na ka rrahur më kush...

Por, edhe pse më nuk e kam takuar kurrë, e falënderoj për sjelljen ndaj nesh...

Më vonë kam mësuar se emri i tij ishte Raif, por ata e quanin Raf.

Pas largimit të tij filloi sërish dhuna ndaj nesh dhe diku pas 32 muaj qëndrimi në Leskovc filluam grevën e urisë...

Dhe, nga greva na dërguan në burgun e Nishit. Por, edhe aty nuk na pritën me lule, por me sjellje të dhunshme. Në fillim na quan në një repart kalimtar, siç quhej atje.

Dhe, kur na nxirrnin në numërim, i shihnim shokët që ishin më herët. Ishte kënaqësi e madhe t'i shihje shokët e idealit, siç ishin: Hyda, Berat Luzha, Gani Krasniqi, Sylë Muja, e shumë të tjerë...

Edhe në këtë burg, për fat të keq, i kalova 18 muaj në izolim, ku ishin torturat më të pakta, por të burgosurit ishin me rrezikshmëri, sepse pjesë e të burgosurve ishin edhe dy serbë provokues, që i kishte dërguar pushteti dhe kë donin e maltretonin...

Ose, i vendosnin në dhomë me ta, e që ishte edhe më keq...

Ishte ndjenjë e rëndë e pasigurisë, sepse më dërguan në dhomë me një Pavloviq dhe sjelljet e atij personi nuk kishin të bënin me njerëzoren.

Kam qenë disa herë i rrezikuar nga ai, ndërsa njëri nga shokët tanë, Sylë Muja, ka qenë në komë 7 ditë prej tij...

Ai ishte 120 kilogramë. Kishte bërë 7 dhunime, por kapaciteti i tij inteligjent ishte tepër i ulët dhe pritej prej tij çdo gjë. Dy muaj nuk kam fjetur natën sa isha me të, sepse e kishim kuptuar se shokun tonë, Sylën, derisa kishte qenë duke fjetur, e kishte goditur me tërë fuqinë dhe e kishte vënë në komë!".



LËSHIMI NGA BURGU

"Ditën e fundit në burgun e Nishit s'mund ta harroj kurrë. Sipas rendit shtëpiak, kur një i burgosur lirohej, lejohej përshëndetja lamtumirëse me ata që mbesnin aty.

Por, neve nuk na u lejua përshëndetja lamtumirëse. Në ditën që u lirova unë, më kujtohet si sot Sherif Konjufca. Nga larg më shikonte... Ai ishte i vetmi njeri me të cilin jam përshëndetur.

Jam ndie fajtor pse unë dola e ai mbet aty...

Dhe, nga ajo derë dola me amanetin e shokëve, me vargjet që i kishin shkruar brenda murit: "Kur të shkosh në Kosovë merre një grusht dhe!".

E, kur arrita në Kosovë, i thash tokës sonë "tungjatjeta" dhe e putha për të gjithë. Sidoqoftë, burg efektiv kam mbajtur 5 vjet, sepse gjykata supreme na i fali disa vjet".

JETA NË LIRI...

"Edhe pas lirimit nga burgu, në asnjë moment, nuk e kam ndërprerë veprimtarinë në forma të ndryshme...

Fillova në punë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për shëndetësi dhe kam marrë pjesë edhe në pajtimet e gjaqeve. Por, në gusht të vitit 1993 ma burgosën vëllanë. E, në shtator të vitit 1993 vendosa të largohem nga Kosova.

Kam jetuar në Belin 17 vjet dhe kam qenë aktiv në të gjitha organizimet që janë bërë në atë pjesë të Gjermanisë, bashkë me shokë, duke qenë aktiv në protesta. Kërkesa ime është: I lus të gjitha institucionet e Kosovës që ta vlerësojnë punën dhe dijen e secilit dhe mos ta vlerësojnë mospunën dhe mosdijen!".

Safet Krivaca



Në kuadër të takimeve promovuese të Unionit, u mbajt tryeza me afaristët e rrethit Koblenz dhe Lahnstein

Pjesmarrës nga Kryesia ishte Kryetari Nazmi Viqa i shoqëruar nga nënkryetarët, Gani Nuha dhe Zenun Krasniqi, drejtori i financave, Vllaznim Kelmendi dhe sekretari, Nexhmedin Veliqi.

Po ashtu Kryesia ishte e shoqëruar nga Koordinatorët e Unionit nga pjesët e ndryshme të Gjermanisë.

Në takim u shfletua rrugëtimi i Unionit që nga fillimi, projektet, organizimet, promovimi i vizionit dhe agjenda e planifikuar për pjesën e dytë të vitit 2022.

Gjatë takimit u bashkëbisedua për temat të ndryshme nga fusha e ekonomisë dhe afarizmit. Ndër tjera tema u shtjellua përparësia e anëtarësimit në Union, rrjetëzimi i afaristëve dhe mundësia e bashkëpunimit të anëtarëve në projektet e përbashkëta.

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH



Afaristët pjesëmarrës e prezantuan fillimisht afarizmin që e ushtrojnë aktualisht dhe pritjet e tyre ndaj Unionit pas anëtarësimit të tyre.

Në përmbyllje të takimit Unioni u pasurua edhe me dhjetëra anëtarë të rinj, të cilëve përziemërisht ju dëshirojmë mirë se ardhje në Union dhe fillim të mbarë bashkëpunimi me anëtarët tjerë të Unionit.

"Po i presim vizat që të shkojmë në muaj të mjalitit!"

Në bisedën e zhvilluar me të riun T. M. dhe me të renë N. A., që bashkëjetojnë në Prishtinë që një vit, kuptuam anët pozitive dhe ato negative që mund të sjellë bashkëjetesa. Megjithatë, shkakut i familjarëve nuk pranuan të na japin foto, e që u mbesim borxh lexuesve tanë.

Biseda jonë ishte spontane, e zhvilluar në një lokal në Prishtinë, teksa pinim kafe...

Si u njohët?

T. M. -Jemi njohur në dhjetor të vitit 2019. Ishte viti i parë i studimeve. Njohja ndodhi spontanisht, meqë banonim në të njëjtin objekt. Kontakti ynë i parë ka ndodhur nëpërmjet dritares, ku unë, si djalosh komunikativ, mundohesha të krijoja njohje të reja me fqinjtë e objektit ku banoja.

Si e keni filluar bisedën për herë të parë?

N. A. -Ha-ha-ha, më kthyet në kohën e njohjes, kur edhe sapo e paskam larguar nga mendja. Mbase tingëllon qesharake, mirëpo gjithmonë kur dilja në dritare, zakonisht për të ndezur cigaren, T. nga largësia më bënte komplimente, e herë-herë edhe më ngacmonte me fjalë. Ka pasur edhe raste kur kërkonte ndonjë cigare dhe gjithmonë isha e bindur se atë e bënte vetëm që ta zgjeronte muhabetin.

A e dinë prindërit për lidhjen tuaj?

N. A. -E dinë motrat e mia se unë jam në lidhje dashurie me T. M., e pak a shumë e



di edhe nëna ime...

T. M. -Nga ana ime e dinë e gjithë familja. Mirëpo, asnjëra nga familjet tona nuk e di për bashkëjetesën tonë, sepse, duke marrë parasysh statusin studentor, mund të keqinterpretohet.

Cili nga ju i bën punët e shtëpisë më shumë?

N. A. -Unë! Unë gjithmonë jam viktimë, sidomos për larjen e enëve...

T. M. -Por, duhet të ceket se të kesh burrë që di të gatujë është fat... E, unë e kam këtë "zanat".

Cili blen a paguan më shumë?

N. A. -Meqë bashkëjetojmë, mundohemi të dy të kontribuojmë njëjtë për gjërat që na nevojiten. Por, meqë i dashuri im punon, ai e ka parasysh se ne jemi studentë dhe nuk mund t'ia dalim mbanë duke paguar vetëm njëri.

Cilat janë të mirat dhe të këqijat e bashkëjetesës?

N. A. -E mira është se kohë të gjatë jemi pranë njëri-tjetrit, por që nuk u ikim dot grindjeve, sepse kalon në një rutinë të përditshme, ku më pas edhe imtësitë më të vogla mund të nxisin grindje. Por, më duhet të cek edhe faktin se gjithmonë është e pranishme frika se mos do zbulohemi, duke marrë parasysh paragjykimet e bashkëjetesës që bëhen në vendin tonë.

T. M. -Për mua e mira e bashkëjetesës është se kemi arritur të njihemi shumë mirë ndërmjet veti, kemi fituar shumë stabilitet në lidhjen tonë, meqë janë shmangur të gjitha dyshimet e mundshme nga të dy anët. Mirëpo, siç e ceku edhe e dashura ime, ndonjëherë nuk u ikim dot grindjeve...

Meqë thatë se grindeni shpesh, a u ka ndodhur më pastaj të mos komunikoni dhe të mbani inate dhe sa ka zgjatur?

N. A. -5 deri 10 minuta! Nuk mund të mbajmë dot inat më gjatë, sepse gjithmonë i dashuri im gjen arsyen të më pyes për ndonjë gjë, ku nuk mund të rezistoj dot pa u përgjigjur ose më vjen të qesh dhe inati bie...

Kur do të martoheni?

T. M. -Po i presim vizat që të shkojmë në muaj të mjalitit! Meqë jemi në provimet e fundit, njëherë jemi fokusuar në mësim, gjë që duam t'i bindim edhe prindërit tanë me suksesin, sepse ata vazhdimisht mundohen të na ndihmojnë edhe materialisht. Dhe, nëse arrijmë sukses në studime, do ta kemi më lehtë t'u tregojmë edhe se bashkëjetojmë...

Paçi fat, pra!

T. M. -Faleminderit! U premtoj se do u thërrasim në dasmë, komplet Redaksinë...

N. A. -Uroj që çdo çift që bashkëjeton si ne të përfundojë me martesë, sepse bashkëjetesa për ne është urë lidhëse për në martesë...

D. Gj.



KOSOVA AIRLINES eurokoha

flyksa.com | eurokoha.eu





Pse i linda 26 fëmijë për inati?

Zgjoheh në mëngjes njerëzit, se pa gdhirë s'kanë qare, pinë kafe kudo në lokalet që, falë Zotit, janë me shumicë... Dhe, edhe pse askush nuk lexon, të gjithë dinë për politikë dhe gjithçka tjetër...

Sot të gjithë janë të mençur!
Nisin t'i komentojnë debatet në studiot e televizioneve tona që i fryjnë zjarrit dhe njëri nga ta e dini ç'thotë:

"Filan moderatori, që udhëheq debatin, është "shtic", sepse po i hasmëron ndërmjet veti njerëzit!".

"Filani e pat mirë kur tha këtë e

atë...", ndërhynë tjetri.
Dhe, krejt ato muhabete mund t'i rumbullakësosh me një fjalë: shqiptarisht! Të gjithë vjedhin dhe të gjithë i kritikojnë hajnat!

Për ta sqaruar më mirë këtë dukuri po e shpalosë një shembull të para 40 vjetëve:

Kur ishte koha e shitoreve që njiheshin si “zadruga”, një fshatari në rrethin e Ferizajt, e që ishte edhe shitës, i ishte thyer shitorja. Hajni ishte futur për tavani. Policia i merr shenjat balistike të hajnit dhe kur i mori ato pa se hajni ishte aty afër.

“Kape hajnin!”, i tha polici qenit. Qeni nuhati pak dhe ia ngjiti të zotit të shitores...

Eh, kështu, disi, kur vjen një emër në krye të një funksioni, ia numërojnë të gjitha të mirat, si, bie fjala me ambasadorin e Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, i cili, pastaj, doli të ishte i korruptuar!

Rasti i njëjtë ishte dikur edhe me ministren e drejtësisë, Dhurata Hoxha, nga radhët e PDK-së, e cila u lavdërua e lavdërua dhe në fund u gjend në bankën e zezë për korrupsion!

Megjithatë, në postet ministrore nuk mund të vijë askush që nuk është në rrethin qeveritar! Vetëm ata që janë brenda tij mund të zgjidhen ministra e zëvendës-ministra, këshilltar e zyrtarë të lartë!

Janë tërësisht të mbushur lëvdata e këngë heroizmesh dhe u përngjajnë burrit që kishte rënë në arkivolin e të vdekurve dhe i thoshte gruas këndomë dhe qaj që të di se kush kam qenë unë... Kishte dëgjuar një burrë vajtimin e grave për një të vdekur dhe, pasi kthehet në shtëpi, i thotë gruas: “Nuk qenka keq të vdesësh grua, dëgjova shumë gjëra që treguan për të vdekurin, besoj se nuk ishte keq të vdesësh.

A thua, a do më këndojnë edhe mua aso lëvdata?”, e pyet gruan. “Shtiru sikur ke vdekur e unë po të këndoj!”, ia kthen grua.

Burri pranon të shtiret si i vdekur dhe gruaja fillon ta vajtojë, duke i ngritur lavde. Në një moment të lavdit burri qan. Kur gruaja e pa se burri qante, i thotë ngrihu, pse qan...

“Moj grua, paskam qenë i madh! Çka bëjnë katundi pa mua?!”. Gruaja ia kërcet shpullë, duke i

thënë të ngrihej shpejt se këto që ia kishte numëruar asgjë nuk ishin të vërteta, por ashtu duhet kënduar i vdekuri.

Andaj, kur kthehet njeriu e mendon, pashmangshëm i thotë vetes: Nuk jemi rastësisht kështu e këtu ku jemi, por tërë kjo është produkt i punës sonë për vet-veten. I kemi punët kështu si jemi vetë...

ISH-I DASHURI IM \\MË THOTË: TY NUK TË MERR ASKUSH!

E kërkoja një lëndë të një historie të viteve 80 dhe shkova në Arkivin e Kosovës në Prishtinë. Më thanë nuk i kemi dosjet e tilla, sepse ua kemi kthyer qendrave rajonale.

Shkova edhe në qytetin rajonal, e çka të shihje: Asnjë dosje nuk ishte në vend! Askush nuk merrej me to... Mungojnë dosjet në arkivat tona shtetërore, mungojnë të dhënat e përjetuara që mund të bëhen fakte në libra shkollore, përmes të cilave u tregojmë fëmijëve tanë se sa kemi vuajtur për ta bërë shtetin, sa na kanë vrarë për republikën tonë, sa na kanë pushkatuar për Republikën e Kosovës...

Po e jap në vazhdim një fjali që e dëgjova teksa pija kafe në parkun e qytetit, fjali që ia rrëfente një femër një femre tjetër, e që, me gjasë, e kishte prishur fejesën: “Jam kah foli me një djalë në Amerikë. Dhe, jo që kam qejf me

shkua atje, por veç për inati të këtij që më la e le të kupë, sepse ma bëke ty nuk të merr askush...”. Dhe, nuk ka muhabet as bisedë ku nuk thotë njeriu ynë se po bën diçka për inati. Askush nuk thotë se po e bën për interesin e vet, të kombit a të lagjes e çka tjetër...

Andaj, edhe mu kujtua fjala e urtë popullore: “Për inati të resë më vdektë djali!”, e kjo i thotë të gjitha...

I LINDA 26 FËMIJË PËR INATI!

Kur e pyet një i huaj një burrë të komunës së Lipjanit pse i ke bërë 26 fëmijë, ai i thotë:

“I bëra për inati të një burri nga Bardhoshi, se ai ka pasur më shumë se unë”.

Pra, çdo gjë për inati të tjetrit...

Kishin qenë ty vëllezër, demek si Hasani e Hyseni dhe kur zgjoheshin në mëngjes uleshin pranë oxhakut të shtëpisë.

Instinktivisht i madhi luante me hirin e oxhakut. E rrafshonte hirin me shuplakën e dorës. Pasi e rrafshonte merrte majën e një krande dhe bënte vija.

Vëllai i vogël ofron kokën të shihet çka bënte më i vjetri. I vogli e pyet:

“Çka po bën?”.

“Po e bëj planin e shtëpisë që do e ndërtojmë”.

“Jo tybe, s’kemi me e bë kështu kurrë, por qysh them unë!”

Dhe, e rrafshonte hirin me shuplakë dore dhe fillonte të bënte vija...

“Ti nuk ke lidhje me shtëpi, prandaj kështu nuk mund ta bësh kurrë!”, ia kthente i madhi vëlla. Kështu, fjalë pas fjale, e qonin ditën, e në mbrëmje i thonë njëri-tjetrit: “Të flemë se për sot boll punuam...”.

S. Krivaça



Pse në Kosovë të gjithë janë të mençur?!

Diti a nuk diti, sot çdokush bën debat politik! Çdo kush bëhet shkrimtar, bëhet poet e çka jo tjetër! Kjo i bie sikur ai që puth mendon se deri në atë moment askush nuk ka puthur më mirë se ai...

Poezia shqipe sot, në tërësi, e ka humbur zhvillimin e saj artistik. Poezia shqipe e viteve 70 ka sjell revolucion përmes rrugëtimit në rrugën e saj revolucionare për unifikim dhe hegjemonizim gjithëkombëtar të kombit. Qoftë edhe një mbrëmje letrare që mbahej diku në ndonjë fshat të thellë të Kosovës, tubonte shkrimtarë, poetë, gazetarë, njerëz të kulturës së shkruar artistike dhe ishte një benifit shpirtëror në këtë art, e që magjepste publikun kur ndonjë emër mërrolej tek recitonte poezi, sepse ashtu më shumë pandehej për patriot që se

kishte shoqin.

Nga ky kënd e thash se është pozitive kjo rënie e zhvillimit poetik për faktin se Kosova tashmë është Republikë, është shtet dhe kjo tregon se ato poezi, për çka edhe i janë kushtuar, e kanë arritur qëllimin. Arsye për të shkruar në atë frymë, që dominonte në vitet 70, kanë pushuar së ekzistuari, sepse është arritur qëllimi. Për një këngë të vetme patriotike apo me frymë nga Shqipëria në sallat e sporteve ku mbaheshin koncerte, të pranishmit ndiznin shallin në shenjë gëzimi se diçka e Shqipërisë ka arritur edhe në Kosovë, qoftë edhe kur ishte një këngë për kooperativën, që tani krahasohet me diçka si krim. Pastaj, kënga, poezia, libri, romani, qoftë edhe një tregim që mund të asocionte në diçka patriotike me ndonjë simbolikë krahasuese, kërkohet për t'u lexuar dhe nga ana patriotike, posa i dilte zëri filan autorit, e kapte UDB-a, sepse me pak diçka të shkruar, çdokush mund të shpallej patriot që po bën diçka për kombin. Dhe, falë kësaj kulture revolucionare në vitin 1978 erdhi një frymë

patriotike që u përshkua me arreste të shumta dhe më pas në vitin 1981 u zbraz dufi shqiptar, e që ishte një akumulator politik shekullor, duke reflektuar kundër Jugosllavisë. Pastaj, erdhën valët e protestave dhe grevave shqiptare dhe erdhi edhe segregacioni ekonomik, politik, social e kulturor në Kosovë, me çka Kosova, de facto, hyri në luftë me Serbinë, duke e lindur edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, që e bëri të veten për ta kthyer tërë botën demokratike kah vetja, kah Kosova. Pra, kjo ishte poezia dikur, kjo ishte kënga dikur, kjo ishte kultura dikur, që reflektoi një fitore të madhe deri te fakti se Kosova u bë shtet. Megjithatë, ishte diçka me kritere. Dihej si botohej libri, dihej si botohej qoftë edhe një poezi, dihej si editohej një këngë apo një album...

KUSH DHE SI BOTON LIBRA SOT?

Tashmë kanë ndryshuar raportet. Libër boton kush të dojë. Vetëm a ke para dhe boto çka të duash... Kanë

dalë një numër autorësh të pamerituar, që kanë nxjerrë libra dhe shtiren si të dijshtëm.

Kanë dalë një numër i madh këngëtarësh që nuk dinë çka është të kënduarit e kënga dhe kanë nxjerrë albume.

Kanë dalë shumë autorë me përmbledhje poezish që nuk dinë ende se ç'është vargu dhe mëtojnë se janë poetë!

Ka një numër të madh njerëzish që mëtojnë të jenë njohës të kulturës dhe artit, e, në fakt, nuk dinë sa bëjnë një plus një në krijimtarinë artistike...

Për ilustrim, marr një shembull: Një djalë kishte për qëllim të dilte jashtë Kosovës për të jetuar, konkretisht të shkonte në Londër. I kishte thënë, me gjasë, dikush se po të kishte libër të botuar do të kishte përparësi atje. Djaloshi në turr i kishte shkruar nja 30 poezi dhe, duke pasur bindje se dinte të bënte krijime poetike, e kishte

botuar një përmbledhje. E kishte marrë taksin dhe e kishte ngarkuar bagazhin e i kishte zbarkuar në stacionin e autobusit në Ferizaj. E takova dhe, si një njeri që më njihte, ma dha një përmbledhje dhe më tha: "Po ta jap gratis ty se e kupton poezinë dhe nuk po të fusë në listën e blerësve!". Mbante shpresën se kishte bërë alamet punë dhe se do ta shiste tërë tirazhin brenda ditës. Ishte djersitur nga entuziazmi se ishte bërë autor i një libri...

"A ke botuar ti diçka?", më pyeti.

"Jo, nuk më ka ardhur rendi akoma!", ia ktheva.

"Të vjen rendi edhe ty...", më tha, duke treguar se ai shpejt ishte bërë emër me atë libër.

Ishte tërësisht në aut. Nuk kishte haber se çka është libri, se kush janë poetët.

Mendonte se do të bëhej menjëherë anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të

Kosovës.

Mendonte se posa të bëhej anëtar i kësaj shoqate do të zinte vend në Londër apo diku tjetër në ndonjë kryeqytet evropian.

E, ai më parë nuk ka botuar kurrë asnjë poezi në revista a gazeta.

Më nuk di se çfarë ka bërë ai me atë libër, por di se sa çifti i tij kanë bërë libër...

Dhe, pasi edhe ai nxori libër, nuk di se kush nuk mund të bëhet sot autor libri...


SECILI MË I MENÇUR SE TJETRI!

E përçolla një emisionin debatues në RTK dhe mbeta i befasuar si shumë herë të tjera:

Kush po merr pjesë në debate?

Sot çdo kush debaton, secili është më i mençur se tjetri...

Sokol Murturi



**PAMJE E QYTETIT TË PEJËS
NË VITIN 1978**

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

BOOM



DISTRIA E ARTË



A më shumë e do Shqipërinë a Kosovën Blerim Destani?



Pas katër vitesh mungesë, aktori i talentuar, Blerim Destani, rikthehet në Shqipëri.

Ai thotë se shkak i punës dhe xhirimeve nuk ka pasur mundësi të vijë në Shqipëri për një kohë të gjatë dhe tregoi se nga hera e fundit që ka qenë, Shqipëria ka ndryshuar shumë.

“Ka katër vjet që nuk kam qenë në Shqipëri, sidomos në Tiranë. Përparon çdo vit e më shumë.

Komplimente për të gjithë ata që e ndërtojnë Shqipërinë. Jam një adhurues i Shqipërisë, sidomos i Kosovës. Unë e kam prejardhjen nga Maqedonia dhe një herë në vit mundohem t'i vizitoj këto vende, por kam xhiruar jashtë dhe isha i zënë me punë”.

Cili profesor e la Mc Kreshën pa fakultet?

Mc Kresha ka bërë muzikë shumë vite përpara se të bëhej i famshëm. Suksesi i erdhi me këngën “Lej fleshat”.

Mc Kresha është ndër reperët shqiptarë me më së shumti bashkëpunime. Ka bashkëpunuar me shokun e tij Lyrical Son, me Dafina Rexhepin, TDS, Leonora Poloskën, Aurela Gaçen, Kidën etj.

Ka disa albume muzikore...

Megjithatë, a e keni ditur se prindërit e Kreshës nuk donin që ai të merrej me muzikë?

Mc Kresha i ka prindërit mjekë, andaj dëshironin që edhe djali i tyre ta vazhdonte traditën.

Megjithatë, Mc Kresha vendosi ta dëgjonte zemrën e tij, të merrej me muzikë.

Ai është i regjistruar në “Psikologji”, por i la studimet shkak i një mosmarrëveshjeje që kishte me një profesor në fakultet...



Sa defekte i ka Luana Vjollca?



Luana Vjollca është njëra nga vajzat më të pëlqyera të ekraneve shqiptare.

Prezantuesja e njohur televizive ka krijuar fansa jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha trojet shqiptare. Pos përvojës disavjeçare si prezantuese, viteve të fundit wshtw marrw edhe me muzikë.

Por, më shumë sesa për zërin, Luana shquhet për bukurinë dhe përmasat trupore. Dhe, me gjithë këtë bujari që Zoti ia ka dhënë, Luana ka thënë se kur e sheh veten në pasqyrë gjen 120 defekte!

“Edhe unë jam si çdo njëri tjetër, që kur shihem në pasqyrë ia gjej vetes 120 defekte, saqë nuk di nga t’ia nisi. Por, jam e lumtur me gjithçka që kam, pavarësisht se njeriu dëshiron gjithmonë më të mirën dhe e mira s’ka fund.

E, kur mendon se edhe e keqja s’ka fund, them: “Faleminderit Zoti!”, ka thënë Luana.

Prezantuesja dhe këngëtarja ka deklaruar se nuk ka asnjë intervenim në trupin e saj, madje as nuk ka shkuar ndonjëherë në palestër sportive...

Pse humbi

Kryetari Legjendar?

Visar Arifaj, që në publik njihej si Kryetari Legjendar i "Partisë së Fortë", ka studiuar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, për dizajn grafik. Në vitin 2005 themloi kompaninë e dizajnit "Trembelat" dhe që prej atëherë punon në këtë kompani, e cila njihet për kreativitet unik.

Pasuria e Arifajt është biçikleta dhe një vizatim i klasës së parë, që e vlerëson një miliard euro! Cili është hobi i tij?

Leximi. Me metaforë, duke ironizuar politikanët...

Por, ka kohë që nuk e shohim as në televizione, por as në portalet tona!

Shtrohet pyetja: Pse humbi Kryetari Legjendar?



Cilat janë

miset tona

prezantuese?

Vlera Jusufi është një nga fytyrat më të dashura të ekranit. Para do vjetësh, në mbrëmjen e maturës, ishte zgjedhur misi i shkollës.

Ishte e veshur me fustan ngjyrë vishnje të gjatë, por të thjeshtë. Mban në mend se i kishte vetëm qerpikët e lyer dhe një shkëlqyes vishnje në buzë.

Nuk ishte e komplikuar si vajzat e gjeneratës së saj apo si vajzat që i sheh sot, e që i kushtojnë aq shumë rëndësi dukjes sikur shkojnë në dasmë...



Shyqyr që s'kam mbetur në Tropojë **me i ru delet!**

Në një rrëfim për jetën e tij, fotografi me famë botërore, Fadil Berisha, ndalet edhe në historinë familjare...

Një aspekt jo shumë i njohur i tij, pasi gjithmonë ka dominuar puna dhe sukcesi... Në vitin 1953 familja e tij emigroi në SHBA, në tokën e

mundësive, u bë shkak një rrethanë jo e favorshme, por që rezultoi të ishte e duhura. "Ta dijë gjithë shqiptaria se unë jam nga Tropoja. Të gjithë mendojnë se jam kosovar. Në të vërtetë, jam nga të dyja dhe i shoh si një, sepse unë kam lindur në Kosovë. Babait në atë kohë i dhanë një detyrë, të vriste një kosovar dhe të mos dihej. Ai s'mundi ta bënte atë gjë dhe i thotë: "Të lutem, mos trego kush të shpëtoi, sepse mua më vrasin!".

Ai tregon dhe babanë e fton qeveria të shkojë në Tiranë, "t'ia japin gradat", por ai e dinte se nuk do ta bënin dhe nuk shkon... Ndaj, babai i Fadilit shpëtoi veten dhe shkoi në Serbi, ku mban 8 muaj burg. Ata i ofrojnë një biletë që të shkonte në një vend tjetër, kudo në botë, ose të qëndronte aty, pa asnjë lehtësi nga shteti. Dhe, ashtu, si shumë emigrantë të tjerë të asaj kohe, ai zgjedh të shkojë në SHBA.

A kanë “armë” VIP-at tanë?

Thonë se jeta është art, mrekulli, luftë, sfidë, paradoks... Sidoqoftë, jeta është e bukur dhe duhet jetuar çdo çast i saj, duhet përjetuar çdo moment me tërë qenien tonë, duke u munduar të marrim gjërat më të bukura nga jeta. Jeta është edhe lojë, duhet shumë punë që ta lozim me sukses. Ashtu siç i ka jeta të gjitha, edhe personaliteti i njeriut është i ndërthurur me shumë veti që e karakterizojnë çdo individ.

Cila është “arma” më e fortë e disa prej personazheve tanë të njohur?

TEUTA KRASNIQI - BESIMTARE E MADHE

Teuta besimin e ka armën më të fortë. Kur njeriu është besimtar, atëherë gjithmonë mendon dhe vepron pozitivisht. Përsosmërinë njeriu e arrin vetëm atëherë kur të tjerëve ua dëshiron atë që ia dëshiron vetvetes.

E, kjo arrihet me besim...




DIELLZA KOLGECI I KA DISA ARMË

Arma më e fortë e një njeriu, sipas Diellzës, është vetë personaliteti i tij. Tiparet, si, bie fjala, vetëbesimi, karakteri, mençuria dhe mirësjellja, janë me rëndësi si armë të forta të një personi.

E, këto i ka Diellza Kolgeci...

LEDRI VULA ËSHTE PËR DIJE

Sipas Ledrit, dituria është arma më e fortë e një njeriu. Kur një person e ka dijen, ai, atëherë, i ka të gjitha, për atë që do të arrijë në jetë.



YLLKA KUQI DHE FORCA E BRENDSHME...

Të kesh forcë të brendshme dhe mençuri janë armët më të forta, sipas Yllka Kuqit. E, jo pamja fizike, jo vijat e trupit...



DAFINA ZEQIRI E KA KËTË ARMË TË FORTË

Për të arritur diku dhe për të arritur diçka, sipas Dafinës, duhet besimi në vetvete. Vetëm me vetëbesim njeriu mund të realizojë atë që synon, e kjo është arma më e fortë e njeriut.

Është vështirë të gjesh femër kur s'ke para!

Rastësisht u gjenda në Qendrën e Studentëve, teksa kërkoja një të afërm timin, me të cilin kisha të kryeja një punë familjare. Më tha se mund ta takoj në mensë, e prej aty do shkonim në dhomën e tij në konvikt dhe do bisedojmë për problemin që kishim.

Por, në dhomë ndodheshin edhe tre cimerë të tij dhe as që patëm kohë ta bisedonim problemin që e kishim, meqë biseda mori kah krejt tjetër...

Asnjëri nuk mbante fshehur asgjë. Dëshirat dhe hallet i ndajnë me njëri - tjetrin. Njërit nga ta i pëlqen një femër zeshkane, si unë, por nuk mund të dalë shpesh me të, sepse nuk ka para të mjaftueshme.

Tjetrit ia kishte marrë mendtë një vajzë në autobus dhe tani kërkonte ndihmën e cimerëve se çka dhe si duhet t'ia bëjë me të.

Ndërkaq, Fisi e kishte mendjen vetëm te provimi që do e ketë javën e ardhshme, edhe pse profesoresha që dy herë e kishte rrëzuar në provim.

PO T'MOS ISHIN LIGJËRATAT...

Sikur të mos kishin obligime në ligjëratat dhe studime, pash se jeta studentore për ta ishte interesante, e papërsëritshme. Secili nga ta fantazonte në mënyra të ndryshme... Më afër meje ishte i ulur Fisi, kështu

më tha se e quanin më shumë nga dashuria, të dashurat e tij të shumta, sepse, sipas tij, kishte zemër fisnike dhe nuk dinte t'ua thyente femrave zemrën.

Një djalë simpatik në pamje të parë, i cili, nga pamja se si ishte veshur, nuk të jepte edhe aq pamjen e një studenti, me një unazë ari në gisht.

"Për mua nuk ka krizë as për para e as për femra. Veç zgjate Zot kështu...", thotë ai. "Nuk kam ndonjë hall tjetër veç nervozes që më ka kapluar që nga një orë: e lamë të takohemi me një femër para Mensës, e ajo s'doli!".

Fisi është nga Gjilani, kurse familjen e ka në Zvicër dhe të gjithë punojnë. Andaj, krizë materiale për të nuk ka, veç asaj që femra e dëshiruar nuk i doli në takim...

"Jam në banesë me qira, por më shumë më pëlqen të rri në konvikt me shokë. Këtu e ndjej veten tamam student. Por, nganjëherë, e sidomos

të dielave, edhe këtu është shkret e nuk rrihet", tregon Fisi, për të cilin tash për tash nuk ekziston asnjë brengë, teksa dy shokët e tij kanë brenga të mëdha...

PROVIMET NUK U ECIN MIRË A DASHURIA PO...

Ai shton se edhe në dashuri punët i shkojnë mirë, me përjashtim të ditës së sotme, e që femra që e priste nuk i doli në takim...

Por, e ka një të metë: nuk mund të krijojë lidhje më afatgjatë me asnjë femër, sepse ato, pasi t'i kuptojnë qëllimet e tij aventureske, ikin prej tij si rrufeja...

"Sa për martesë ende nuk po mund të gjej femrën e dëshiruar, femrën ideale. Pse, vëlla, nuk tregojnë drejt se sa frajera i kanë pasur, por gjithmonë më thonë se jam i dyti... Pra, kurrë as i pari e as i treti... Asgjë të keqe s'ka, por pse

të mos e thonë të vërtetën.

Sidoqoftë, nëse më shkojnë punët me dashuri edhe në të ardhmen siç po më shkojnë tash, pse të martohem e të marrë obligime familjare", shprehet ai. E, unë, me nguti, i them: "Ti, a i tregon të dashurës se për sa kohë do të jesh në lidhje me të?".

Ma kthen: "Nuk e di sa kohë do të jem me të, andaj edhe nuk i tregoj".

"E, ku ta di ajo se ti do ia kthesh shpinën pas një nate me të?".

Dhe, shpërthejnë të qeshurat në dhomë...

Por, në pyetjen: "Me provime si i ke punët?", më thotë:

"Edhe me femra mirë e edhe me provime mirë, këto të dyja nuk shkonjë bashkë..."

E GJEN FEMRËN, POR SI ME E MBAJT?

Visi dhe Neli, meqë të dy janë nga Vitia, thonë se vetëm të premtëve dhe të shtunave në mbrëmje dalin, sepse edhe vajzat e konvikteve ato ditë dalin më shumë...

Problemi më i madh për ta është se që të dalin me ndonjë femër duhet t'i kursejnë paratë që ua japin në shtëpi. "50 euro m'i dha babai kur u nisa të dielën për në Prishtinë. Çka të bëj më parë me ato para? Edhe nëse e gjej ndonjë femër nuk kam guxim t'i them të pimë diçka...

Sot është lehtë të gjesh femër, por është vështirë ta mbash, sepse jeta dashurore e studentit kushton.

Unë studente ajo studente... Të dy pa para. Keq, a!?" shpreh brengën e tij Visi, 21 vjeç, i cili javën që shkoi e kishte pasur një provim të vështirë në fakultet dhe kishte rënë për së treti herë...

ËSHTË VËSHTIRË TË KESH FEMRË KUR S'KE PARA!

Ai, duke mos ditur se unë po e regjistroja në trurin tim gjithë këtë muhabet, tregon tutje se si një ditë e kishte ndalur në rrugë femrën, të cilën kishte kohë që e përcillte nga larg.

Mirëpo, në momentin kur ishte bërë gati t'i thoshte që të uleshin diku në kafe, i ishte kujtuar se në xhep i kishte vetëm 5 euro, e që i duhet t'i ruajë për të paguar biletën për në Viti, që

të shkonte të premtën në familje, në shtëpi.

"Që nga ajo ditë ajo më nuk më flet, e as që më shikon bile! Ndoshta e kam humbur përgjithmonë! Nëse ndodh ta takoj sot nuk di si do të arsyetohem pa i thënë të pimë kafe, sepse dje i harxhova paratë e fundit, e në telefon u thash t'mi dërgojnë pak para me autobusin që niset nesër në orën 7 nga Vitia për në Prishtinë. Pra, e shihni sa vështirë është të kesh femër kur nuk ke para?!", shprehet Visi, i zhgënjyer me gjendjen e keqe materiale që ka.

Po të njëjtin hall ka edhe vendasi i tij, Neli.

"Edhe femrat po ikin prej nesh kur po shohin se jemi keq materialisht. Thënë të drejtën, po u dhimbsemi...

Andaj, që nga dita e nesërme do të dal kafiq më kafiq dhe do të kërkoj punë, kuptohet me orar të shkurtër, sepse ligjëratat dhe provimet nuk do t'i lë anash kurrësi", thotë i nervozuar me vetveten Neli.

S'KA DOBI NGA POLITIKA!

Dhe, teksa muhabeti zgjatet për dashuri, sa për t'i nxitur u them se në konvikte a flasin vetëm për provime e dashuri, apo edhe për politikë...

"Nuk dua të flas për politikë, sepse nuk kam kurrfarë dobie prej kësaj

pune. Politikanët e këqyrin punën e tyre, e as që u intereson se si i kemi punët ne, studentët...

Prej asnjë partie s'ka hajr, sepse secili po i punëson të vetët. E, neve s'ka për të na ardhur koha të punësohem edhe po të diplomojmë me notën 10!", flet me nxitim Visi.

"Hiq more politikës, nuk ka hajr prej saj, por si me i krye provimet dhe me e gjet një femër që do më bëhet nusja ime e jetës?! Ky është synimi im... Kjo është ardhmëria ime... Kjo do i gëzonte familjen time... të afërmit e mi...", ndërhyr me një të folur shumë të shpejtë Neli.

HARRUAN TË PINË ÇAJ...

Nuk kisha më shumë kohë t'i dëgjoja, përndryshe në mendjen time, trurin tim, do regjistroja edhe shumë e shumë gjëra interesante nga biseda me ta...

Të tre, pas pak, njëzëri thanë:

"Uh, bre, dashuriçkat dhe femrat na e morën natën! Kemi harruar të bëjmë çaj! Sepse, me çaj biseda do të ishte edhe më e ngjeshur, më e lezetshme... Fantazojnë e fantazojnë... Asnjëri nuk ka ndonjë orientim se kur do të diplomojnë...

Fundja, siç thanë njëzëri, jeta është përpara...

Diturie Haxhaj



Pse më zuri sherri me mjeshttrin e Jezercit?

Para pak ditësh më thirri në telefon një njeri nga Jezerci i Ferizajt, vend malor, e që njihej për burra me trimëri. Por, edhe për punë mjeshtërore...

Jezerci ende e ruan traditën mjeshtërore për punë me gurë. Ai pat punuar disa muaj te unë. Ia kisha dhënë paratë para nja një viti e gjysmë, në formë kopari. Erdhi me punua te unë dhe i bënim muhabet të mirë: bukë, kafe e tortë para dite në orën 9, kafe e çaj në orën 12, çaj në orën 15 dhe një orë më vonë shalqi dhe gjatë tërë ditës lëngje frutash e birrë sa herë ia ka dashur qejfi. Kur kreu punë - u barazuam me pagesë, por i mbeta borxh 100 euro. Kur i bëra paratë e thirra, por nuk erdhi t'i merrte se ishte i zënë me punë. Më thoshte kur të kaloj andej pari vije e i marrë...

KUR TË VRET BUKA JOTE?

Më cingëroi telefoni dhe e hapi. Ishte mjeshtri i Jezercit. U gëzova që ia ndieja zërin, por nuk ishte zëri i tij, por numri i telefonit të tij po. "Si je? A jeni mirë, o mjeshtër", i them unë. "Nuk jam mjeshtri, por djali i tij", më thotë ai. "E, sa herë duhet të të thërrasim për ato 100 euro?!". Mendova se po tallej. "A e ke njëmend, a?!", i them. "Po, njëmend!", më tha me zë të lartë. "A po ma jep babanë tënd?", i thash. "Po", më tha. "Mjeshtër, lëshoje interfonin që ta dëgjojë edhe yt bir bisedën tonë!", i

thash.

"E lëshova", më tha.

"Mjeshtër, sa herë të kam thirr që t'i jap paratë e ti nuk ke ardhur?", i thash.

"Po, por e kam plakun në spital dhe nuk kam pasur kohë", ma ktheu ai.

"A e meritoj t'mi thotë yt bir këto fjalë?!"

A e mban mend sa muhabetin ta kam bërë me gjithë familjen time?

A, kështu duhet me e kthye të mirën, a?!", ia ktheva.

Dhe, ende pa ia mbyllur telefonin m'u kujtua thënia: "Kujdes se të vret buka jotel!"

Por, buka edhe të nderon...

S. M.

tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269336233 [/touristcamping_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)


Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269825858 [/giovannis_beach_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)



NË ÇASTIN E PARË KUR TË PASH...

Ti je ajo që zbardh *terrën e natës!*

U njohëm rastësisht, por bukuria jote atë mbrëmje më pushtoi e më mori me vete. E gjatë, shtathedhur e me fytyrë engjëjlore, më magjepshe që në pamjen e parë, ndërsa shikimi yt i mprehtë i dha flakë zjarrit të sapo ndezur të dashurisë, i cili në zemrën time ishte fikur që moti...

Rastësisht ndodhesha në një qosh të një restoranti të heshtur bri rrugës, në të cilin po pija kafe me mikun tim. Nuk më kishte shkuar mendja se në atë vend, ku mbizotëronte një heshtje varri, që e bënte ndejën monotone, do shfaqej një bukuroshe si ti, e cila do i ndryshonte rrjedhat e asaj mbrëmjeje të zymtë.

KU SHKELTE KËMBA E SAJ KISHTE GJALLËRI...

Sa bëre hapin e parë brenda asaj salle të madhe të restorantit pa mysafirë të tjerë, ndjeva sikur ambienti i zymtë u gjallërua, u bë tërheqës. Kisha fat që isha me mikun, i cili njihej me shoqen tënde që të shoqëronte, sepse, duke iu falënderuar asaj njohjeje të tyre, ju,

të dyja, erdhët te tavolina jonë, për t'u ulur bashkë me ne.

Qëkur hyre brenda, i kishe ngulitur sytë në mua dhe nuk po e shkëpusje shikimin, shkëlqim i cili do i shkrinte edhe shkëmbinjtë e Mirditës.

Ata sy sikur donin të flisnin, gjë që më bënte të kuptoja se po të pëlqeja që në shikim të parë...

E, kur erdhe afër, u përshëndete me ne dhe ma zgjate dorën.

"Jam Hana", u prezantove akoma pa zënë vend.

Unë, fillimisht, nuk u prezantova, por vetëm ta shtrëngova dorën, të cilën ta mbajta pak më gjatë se zakonisht. Gjatë atyre pak sekondave të shikova me shpejtësi fund e krye. Dukeshe e bukur, dominuese, luaneshë e fuqishme që zotëron territorin...

AJO E ZBARDHË TERRIN E NATËS!

"Ti qenke hana, ajo që zbardh terrin e natës, a?!", ishin fjalët e mia pak a shume provokuese, me të cilat jo vetëm që theva heshtjen e shkurtër, por me to aty për aty hapa bisedën, e cila gjatë ditëve në vijim do na afrojë shumë mundësi për t'u afruar me njëri-tjetrin.

Ti në vend të përgjigjes m'i ngulite sytë dhe buzëqeshe. Mu duk sikur paksa u skuqe në fytyrë, apo ndoshta buzëkuqi yt ngjyrë qershie reflektoi në fytyrën tënde.

"Është dielli ai i cili ndriçon botën më tepër se hëna", ma ktheve aty për aty, për t'i dhënë fuqi e kah dominues

pozitës sime.

Me ato fjalë, me të cilat edhe nisi njohja jonë, bëre që unë të ndjehesha i fuqishëm pranë teje. Të shikova në sy me shikim të mprehtë e pushtues, me ndjenjën se i përngjaja një luani që mbisundon xhunglën, pranë të cilit qëndronte luanesha e fuqishme, por e dëgjueshme...

Dhe, biseda që pasoi e vërtetoi një gjë të tillë, e bëri të këndshme atë mbrëmje, e që me sharmin tënd e vrave zyrtësinë...

Pa lënë hapësirë që biseda e filluar të ndërrojë kah tjetër, u ktheva me trup edhe më shumë kah ti dhe fillova t'i prekja gishtërinjtë e dorës tënde që rrinin mbi tavolinë. Ti nuk e largove dorën, por e shtrive akoma më pranë meje, duke më dhënë shansin për ta prekur e ledhatuar edhe më shumë.

"Ti hëna e unë dielli", belbëzoja sa për ta thyer heshtjen, duke e rrëshqitur ngadalë dorën time mbi tënden.

Më shikove ëmbël. Dhe, pa hezituar, dorën tjetër e vure mbi dorën time, për t'i bashkuar duart tona.

"Nëse jemi si hëna e dielli, jemi edhe si toka e qielli", shtove ti.

PUTHJA E PARË NËN SHNDRITJEN E YJEVE...

Në mendjen time i risillja fjalët e thëna, me të cilat më lartësove dhe më dhanë shtytje të të propozoja shëtitje jashtë sallës së restorantit, shëtitje nën qiellin e hapur e të errët.


Kur dëgjove propozimin tim, shikove miken tënde, e cila në ato çaste bisedonte me tim mik. Sikur doje pëlqimin e saj për të dalë me mua, jashtë restorantit... U ngrite lehtë, duke më shikuar në sy...

Jashtë restorantit dëgjoheshin lëvizjet e automjeteve... që vraponin magjistralës. Dritat e tyre shpërthenin terrin dhe verbonin shikimin tonë. Andaj, edhe na u dashtë të shmangemi nga rruga.

Dhe, nuk e di se si u gjetëm me fytyrë ballë njëri-tjetrit, por di se buzët tua u ngjiten me buzët e mia... Ishte puthja jonë e parë, e që vazhduam edhe me të tjera një kohë të gjatë. Mes puthjeve fillove të flisje, por nuk të lejoja, sepse më shumë i doja puthjet sesa fjalët...

Dhe, gjatë qëndruam atë mbrëmje nën qiellin e hapur, të përqaftuar e ledhatuar. Në atë vend çdo gjë nisi rastësisht dhe, më pastaj, nga aty mori udhë dashuria jonë e përvetshme...

P. K.



KËSHTU JETOHEJ
NË KOSOVË NË VITET '70


HELPER
GENEVE



www.helferwatches.com

 /helfer_lifestyle




Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

Ç'thonë të anketuarit për dhunimet?



Merita, 22 vjeçe, studente nga Prishtina, thotë se mediet duhet t'i kushtojnë hapësirë më të madhe temës së dhunimeve...

Është shumë pozitive që vajzat e dhunuara, pra që bëjnë dashuri pa dëshirën e tyre, të flasin dhe ta kurajojnë njëra-tjetrën se duhet të flitet për këtë temë dhe se askush tjetër nuk mund ta përçojë zërin e dhimbjes më mirë se vajzat e dhunuara.

Ajo sjell kujtimet nga kampet e Stankovecit në Maqedoni, gjatë kohës së luftës, kur pat biseduar me disa femra që janë dhunuar...

"Unë kam qenë banore e kampeve në Maqedoni. Gjatë tre muajve sa kam qëndruar atje, kam pasur rastin të dëgjoj shumë rrëfime të tmerrshme nga të dhunuarat që i mbanin në vete përjetimet e tmerrshme..."

E, kjo është dhembje që ta kallë shpirtin kur dëgjon rrëfime të tilla, prandaj gazetaret, portalet e intelektualët, duhet ta shpërndajnë gjithkrah faktografinë e dhunimeve në Kosovë, sepse shpesh na bie të lexojmë a dëgjojmë se filan

vajza u kidnapua dhe u dhunua e të tjera të ngjashme...

TË ASHPËRSOHEN LIGJET!

Nadirja (31), infermiere, di se ka të dhunuara në Kosovë, por edhe më shumë në Shqipëri.

Si femër që jam, në lëkurën e motrave që kanë përjetuar këto pasoja, më dhimbsen ato, sepse e mendoj veten po të isha njëra prej tyre...

Andaj, kërkoj që ligjet të ashpërsohen dhe dhunimet të dënohen maksimalisht.

D. H.



Vend ideal për banesën tuaj!
Kompleksi Ulpiana Center

   www.cimaks.com

Kompleksi Ulpiana Center

Rr.Shqipëria, Lipjan



+383 49 50 90 90



www.cimaks.com

Pse plaku 90 vjeç u ngrit në këmbë për mua?

Sonte nuk kam gjumë. Më sillen mendimet vërdalë... Dhe, teksa përpëlitem të fle, më kujtohet një ngjarje që më ndodhi në fshatin Mirash të Ferizajt...

Sillen mendimet e mia përgjatë dhomës. M'u kujtua një ngjarje në një odë të fshatit Mirash të Ferizajt. I kishte vdekur babai një moshatarit tim, që më quante dajë, por kurrë s'e kam ditur pse e kam dajë.

Babai kishte vdekur moti, e unë kisha qenë tepër i vogël të pyesja pse e kishim dajë filanin që vinte në odën tonë.

U nisa të shkoja ta vizitoja dajën dhe kur arrita atje u drejtova drejt e në odë. Një sallon 13 metra i gjatë, që shfrytëzohej për odë burrash. Më ulën në fund të sallonit, atje ku ndodhej përballë një plak. Ishte mbi 90 vjeç.

U HABITA PSE PLAKU 90 VJEÇ U NGRIT NË KËMBË PËR MUA?

Pasi mbretëroi heshtja, u hapë biseda ngushëlluese. Plaku, që e kishte pranë një kujdestar interpretimi, ofroi veshin afër tij dhe kujdestari i tregoi se kush isha.

Plaku i dha të ngrihej në këmbë, por të tjerët reagueshan, duke i dhënë se s'ka



nevojë të ngrihej.

Por, megjithatë, plaku tha: "Unë dua të shkoj te ai e jo ai të vjen këtu".

U ngrit dhe e morën dy veta për krahësh dhe e ofruan pranë meje. Kur më mori ngrykë filloi t'i dilnin lot nga sytë...

Në ato çaste u ndjeva ngushtë për gjendjen e tij. Oda ishte plot burra dhe diçka e madhe duhej të kishte ndodhur që ai u ngritë e erdhi te unë, thash me vete...

Nuk ishte ngritur për asnjë komandant policie, që kishin shkuar në pamje, meqë djali i të vdekurit ishte komandant policie në Prishtinë. Njëri tha: "Ti bre burrë duhet të jesh i madh se plaku nuk është ngritur në këmbë deri më tani për askënd!".

Plaku me të ardhur afër më tha: "A i ke përngjarë babës?".

"Jo, nuk i kam përngjarë shumë, por ka diçka që kemi të përbashkët", i thash.

Pas këtij dialogu më tha se kishte qenë mik e shok i besës së babait

tim, qyshkur kishin qenë ballistë në male dhe e kishin shkelur në këmbë Shqipërinë deri në Tivar.

Unë, për ta relaksuar situatën e krijuar, që te të tjerët zgjoi interesim të madh ardhja ime në odë, i thash:

"Unë mendova se vetëm pse jam i madh me trup të bëra përshtypje e u ngrite në këmbë për mua! Por, po e tregoj një mesele: E pata gjetur një këlysh të vogël dhe e qova në shtëpi. Baba u qua nga vendi që ta shihte këlyshin dhe unë po e gënjeja se ishte i racës së Sharrit, bëhet kështu e ashtu, e mbytë ujkun e lavde të tjera për këlyshin, vetëm e vetëm që të mos ma humbte".

Ai ndërhyri duke qeshur: "Ky nuk bëhet qen i madh, biri im, sepse është pinok. Nuk na duhet qeni i vogël në oborr, sepse qenit të vogël askush nuk ia ka frikën... e të madhit po".

E, edhe unë mendova pse jam i madh me trup u ngrite në këmbë për mua!

S. Murturi



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht priten që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamt, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamt.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamtin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



Nastradini i thotë gruas: "Të premtën e kam një punë. E, që të mos e harroj terminin merre këtë shkop dhe ma lë mbi tavolinë, në mënyrë që ta di se është e premtë!"

Gruaja i lë shkopin mbi tavolinë dhe me të hyrë Nastradini brenda, shkopi i përplasët në kokë. Shpejt e shpejt i thotë gruas: "Sot nuk është e premtë, grua, ç'dreqin e ke lënë këtu shkopin?". "Është nata e së premtes dhe u desh me e mbajtur marrëveshjen", ia ktheu ajo.

Pse e kam idol Nastradinin?

Nastradini kishte pasur shumë punë. Nuk i mbante në mend gjërat dhe, meqë i ishte zhvilluar harresa, gruas i tha: "Më ndihmo, grua, ta kaloj harresën! Dhe, si e bëri?"

"Më dëgjo grua, nga sot në këtë shtëpi o shkopi o unë!", tha ai.

JA UNË E KAM MIRË JA MJEKU...

Shkon im shok te mjeku për kontroll, e ai i thotë:

"Me heq peshë se do të kesh më vonë probleme kardiologjike".

"O doktor, falënderohuni për peshën që kanë njerëzit se po të ishin të gjithë pa mbipeshë nuk do u vinte kush dhe ju më nuk do ishit mjek, por kushedi çka tjetër. Unë, po të mos kisha mbipeshë, ç'do të kërkoja këtu? Me siguri, asgjë!", i thotë ai. Por, doktorët tanë nuk janë si Nastradini që të fitojë një dhjetëshe më pak, por për të krijuar bindje po e tregoj edhe këtë punën e dhjetëshes:

Një grup të verbërish kishin arritur deri te lumi dhe prisnin që dikush t'i nxirrte andej lumit...

Nastradini u tha se do i bartte andej për nga dhjetë grosh. Nxori disa dhe u kthye t'i merrte edhe të tjerët. Por, kah mesi i lumit një të trashë, e që kishte shumë peshë, e hedhë në lum.

Kur e hodhi ai nisi të bërtiste e britmën e kuptuan të verbrit dhe i thanë Nastradinit: "Miku ynë, ti e hodhe dikë në ujë e do të mbytet".

"Në fund të fundit, një dhjetëshe më pak e më shumë s'ka rëndësi", ua ktheu ai.

PARATË NË RRUGË – SYTË MBYLLUR!

Pra, kur ta jep Zoti ta jep, ama neve nuk po na bën Zoti shtet si duhet... Jemi bërë si ai që nuk i ka marrë paratë e shokëve për të nisur jetën e vet...

Ishin disa miq, por njëri prej tyre ishte i varfër. Një ditë ata morën vendim ta bënin me shtëpi mikun e vet.

U morën vesh që t'i lënë para në rrugë. Ia

mbushën një strajcë me para dhe ia lanë në rrugë, mbi një urë, duke shpresuar se ai do kalojë, patjetër, aty pari dhe do i gjejë. Por, kur erdhi te ura i tha vetes: Do i mbyll sytë e të provoj se a do mund ta kaloj urën symbyllazi...

"Oj urë, që 50 vjet po kaloj mbi ty e të kam mësuar përmendësh, andaj sot dua të provoj a mund të të kaloj symbyllur!". Dhe, i mbylli sytë e nisi rrugën nëpër urë. Kështu, kaloi pranë thesit me para dhe nuk i pa...

Atëherë, shokët thanë: Lëreni se nuk mund ta bëjmë shtëpi me zor! Kështu edhe neve, më duket, Zoti nuk e ka shkruar të na bëjë shtet si duhet... Edhe këtë po e lidhi me një rast që i kishte ndodhur Nastradinit: I kishte vdekur gruaja Nastradinit dhe pas një kohe merr gomarin dhe niset për diku...

Me të arritur te shtëpia e një vejushë, i bërtet gomarit:

"Ush gomar në botën tjetër!".

Vejusha e dëgjoi dhe i tha:

"Pse të vete gomari në botën tjetër, efendi?".

"Më ka vdekur gruaja, zonjë, e dua të shkoj ta shoh".

"Prit sa t'ia bëj një tortë e merre me vetel".

Nastradini priti derisa u bë torta, e mori me vete dhe u nis. Kur u largua paksa, u ndal dhe e hëngri tortën...

Kur u kthye në mbrëmje në shtëpi, e takoi përsëri vejushën, e cila i tha:

"Nastradin efendi, pse dukesh i mërztur? Me siguri, qenke mërztur për gruan?".

"Jo zonjë, nuk është që jam mërztur, por mua e ty na kish gjetur një e keqe e madhe: burri yt atje ishte martuar me gruan time!".

"Efendi, a edhe këtë të zezë e paska bërë burri im, a? A martohemi edhe unë e ti për inati të tyre?".

Selim Rama



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Letra që vret...

Përshëndetje, jam nënë, 47-vjeçare, vuaj nga një sëmundje e rëndë. Kemi një djalë të vetëm që na e fali Zoti vonë, e pas lindjes së tij burri im vdiq aksidentalisht e më la të përballem me djalin që është rritur... Nuk më dhimbset vetja ime se edhe ashtu kam pasur jetë të rëndë si te baba ashtu edhe në martesë, por nuk di çka t'i bëj djalit...

Nuk i kam kushtet ta rrisë e të merrem me të. Jam e sëmurë, por më shumë jam e plagosur për tim bir si do të jetojë pa mua, si do të arrijë ta sigurojë kafshatën e gojës...

"Nëna me lot"

Përgjigje:

Para së gjithash, Allahu xh. h., ka jetë për të gjithë. Ka edhe ilaçe për të gjithë, ashtu sikur mund të ketë edhe për ty. Ka bukë edhe për djalin tënd e për fëmijët tanë...

Më e rëndësishmja është të shëroshesh ti dhe të jetoni së bashku me të birin, derisa ta shohësh të martuar e me fëmijë.

Mos paragjyko më të keqen, jetoje jetën me dinjitet, por kujto se në botë ka drama shumë më të tmerrshme njerëzore që ndodhin në vendet me të zhvilluara dhe sot askush apo pak kush është i

lumtur nga jeta dhe pak kush di t'i gëzohet jetës.

Këtë pakënaqësi njerëzore të këtij shekulli e dëshmon fakti se në çdo 40 sekonda të jetës, një njeri bën vetëvrasje në botë, apo ia merr jetën vetes, duke mos qenë i kënaqur me asgjë dhe duke mos parë dritë në fund të tunelit.

E, kur njeriu mendon se në çdo 40 sekonda dikush e privon veten nga jeta, duke ia marrë të drejtën vetes të jetojë, kjo tregon se sa të palumtur janë sot njerëzit që nuk shohin arsye për të jetuar...

Sa i përket sigurisë jetësore, askush nuk jemi të mbrojtur as nuk kemi garanci se do jetojmë deri nesër. Shpërfaqja e cilësdo sëmundje është vetëm një alarm që bëhet i ditur për çdo kënd se në moment është pacient, por pak kush di se për çdo ditë në trupin e njeriut vdesin rreth 36 milionë qeliza, që kanë të bëjnë me ndryshimet metabolike.

Kjo tregon sa të pambrojtur jemi përballë sfidave të shekullit XXI, që ka më shumë tym e gaz sesa shëndet dhe ekologji...

Mos u dëshpëro, por kujtoji të gjitha këto dhe mendo bardh e jo zi! Te njeriu është një motor që e shtynë tërë makinën: Shpresa! Ajo nuk duket, por e bën shpirtin të besojë të mirën dhe kalimin

e krizës. Ndodhin në jetë shumë gabime, ndodhin edhe te njerëzit më elitarë. Nga gabimet e mjekëve dhe trajtimet e gabuara në botë vdesin afërsisht 10 mijë njerëz në ditë.

Fati i munguar, a kam depresion?

Zonja magjistare, jam një vajzë 30-vjeçare, jetoj në Gjermani. E dua një djalë me të cilin shihemi më shumë në vendin e punës, por unë nuk jam e vendosur për askënd, sepse më duket kam depresion.

Kështu, dashurohem shpejt e pastaj nuk mund t'i shkoj deri në fund asnjë mundësie!

Kam probleme me veten time, nuk jam e sigurt në rrugën që e marrë.

Nuk di a kam depresion apo çka po ndodh me mua?

"E hutuara"

Përgjigje:

Ti ke pasur një lidhje disavjeçare me një djalë atje dhe pastaj jeni ndarë. Ju keni pasur ambicie të martoheni, por shkak i një kredie e keni prishur lidhjen tuaj edhe prej atëherë ti nuk je në disponim për dikë tjetër.

Shpirti yt fle e pushon vetëm te ai që, siç thotë populli, "e ka hequr duvakun tënd".

Për të qenë me dikë tjetër duhet kaluar kohë. Tani për tani nuk shoh se je e gatshme për një lidhje të re, sepse truri dhe shpirti duhet të mësohen me një pamje të re dhe me një sjellje të re, që vjen përmes personit që do ta gjesh, e njeriu nuk është makinë statike që funksionon vetëm kur ndizet, por njeriu në çdo kohë është në funksion me kapacitetet e veta psikomotorike, për çka do kohë të shërohen ndjesitë që keni krijuar për pesë vjet me personin...

Shoh pak depresion te ti, sepse zor është të mësohesh me dikë tjetër. Por, një fjalë e urtë thotë: "Koha shëron!"

Jam duke bashkëjetuar me të fejuarin. Pse mërziten prindërit e tij?

Zonjë, jam një vajzë 23-vjeçare, në studime në Prishtinë. Jam nga Gjakova. Kam një të dashur me të cilin jemi duke bashkëjetuar qe dy vite.

Kemi shpesh mosmarrëveshje, por e di se më do mjaft shumë. Unë e kam një brengë, sepse nuk di pse më thotë se po mërziten prindërit e tij...

"Pa shifër"

Përgjigje:

Ju nuk e keni bërë zyrtare lidhjen tuaj. Nuk jeni fejuar akoma dhe se ju duhet ta dalloni fejesën dhe aktin e fejesës me një mbyllje në banesë me qira larg rrethit tuaj. Çka është fejesa duhet t'ua sqaroj, sepse ka shumë pyetje me këtë tematikë dhe mjerisht koha po sjell gjëra të pasitura dhe që janë kuantitet i jetës, për çka ka thënë - prindërit po mërziten... Unë i kuptoj plotësisht se ata prindër e dinë se djali i tyre nuk është duke vepruar në rregull me ty.

Fejesa është akti i zyrtarizimit të një lidhjeje. Është paramartese, është një tubim i njerëzve të ftuar nga djali që fejohej, por edhe familja e vajzës fton të afërmit e vet.

E, a ka diçka prej këtyre gjërave që ju keni mbaruar pasi po bashkëjetoni?

Nuk ka asgjë. Askush mund të mos e di lidhjen tuaj. Jeni takuar në Prishtinë, jeni njohur, mund të flini së bashku në banesë dhe, më pas, secili në drejtimin e vet.

Askush prej jush nuk ka të drejtë

morale as ligjore të kërkojë prej palës tjetër llogari. Kjo nuk është fejesë, ky është një kalim i shfrenuar që e ka sjell koha si dukuri të papeshuar.

Ti atë djalë nuk e ke as të fejuar e as burrë. Jeni dy të rinj që po i shfrytëzoni ndjenjat e njëri-tjetrit për një kohë sa jeni në Prishtinë. Prandaj, kanë arsye të mërziten prindërit e tij, por edhe prindërit tu.

Pra, ashtu sikur jeni ofruar, ashtu edhe do të ndaheni...

Çfarë qëllimi ka ish-i dashuri im?

Jam një vajzë 27-vjeçare, jetoj në rrethin e Ferizajt. Kam pasur një të dashur me të cilin kemi qenë së bashku 7 vjet, por ai u martua. Ndërkohë, ai shkoi jashtë, ku i ka bërë letrat...

Kemi pasur shumë dhimbje të dy, kemi derdhur lot...

Pasi u martua ka një kohë që më është lajmëruar përsëri dhe direkt më ka ofruar martesë, duke më premtuar besnikëri.

T'i besoj apo jo? Çka më preferon?

"E humbura"

Përgjigje:

Unë kam mendim negativ sa i përket ribashkimit tuaj me martesë. Këshilla ime është ta gjesh fatin tënd. Mund të ndodhin shumë gjëra të pakëndshme nëse ju lidheni përsëri...

E para, ribashkimi juaj me martesë do të qonte në ndarjen e tij nga gruaja që ia ka bërë letrat atje. E dyta, është problem pastaj t'i mbeten letrat atij.

E treta, mund të ndodhë çrregullim ndërfaqiljar, e që mund të prodhojë krejt situatë ndryshe... Këshilla ime është: Kërko fat të ri dhe harroje atë person!

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Pse jam e mërzitur, a po bie në depresion?

Jam një zonjë 40-vjeçare. Kam tre fëmijë. Nuk jam për momentin duke punuar. E kam mbaruar fakultetin, por jam e pa punë. Kohëve të fundit po ndihem keq, zonjë, sepse po ndjehem shumë e mërzitur.

Çka po ndodh me mua? Kam probleme, gjithashtu, se me duket po rrëshqas kha depresioni.

Të lutem, mos m'i shëno të dhënat e mia, ma jep vetëm përgjigjen...

"E dërmitura"

Përgjigje:

Kjo që ke treguar ka të bëjë me degradimin e aktivitetit tënd fizik dhe me ndjenjën se ke mbetur pa vlera dinamike.

Ti ke krijuar familje dhe fëmijët janë në pozita të ngritjes shkollore fakultative, e krejt kjo do të duhej të ishte një stimulues shpirtëror për ty, që të bësh përpjekje për familjen.

Ka edhe diçka që i ka shërbyer për keq kësaj gjendjeje, sepse në vendin ku ke punuar ka qenë i adhuruari të cilin është mësuar syri ta sheh çdo ditë e kjo mungesë tani ka bërë që t'ju mungojë diçka e shumëçka dhe krejt kjo është si një re e mbushur me shi, por që shkarkohet mbi tokë për mes stuhisë dhe breshrit!

Kujdes, mos kaloni në gjendje të turbullt! Rrugën e keni të qartë kah duhet të shkoni. Prandaj, nuk duhet të ketë vend dëshpërimi në shpirtin tuaj...



SHERWOOD

Resorts and Hotels

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

www.sherwoodhotels.com.tr
+90 444 88 07